

Nr. 17212/Prot.

Lezhë, më 25/10 /2022

PROCESVERBAL

I mbajtur me datë 25.10.2022 në orën 17:00 në ambientet e Bar Restorant “Suli” në autostradë (në Njësinë Administrative Dajç) me prezencën e panelit prej 6 anëtarësh:

1. Zv.Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Ermal Pacaj,
2. Zv.Kryetares së Bashkisë Lezhë- Znj.Eueda Molla,
3. Kryetarit të Këshillit Bashkiak Lezhë -Z.Ndue Luli,
4. Administratori i Njësisë Administrative Balldre-Z. Redon Gjeloshi,
5. Administratori i Njësisë Administrative Kallmet- Z.Eraldo Marku,
6. Administratorja e Njësisë Administrative Dajç- Znj.Majlinda Miloti,

si dhe banorë të njësive administrative Balldre, Blinisht, Kallmet dhe Dajç.

Takimi u hap nga Zv.Kryetari i Bashkisë i cili në fjalën e tij shprehu pritjen e propozimeve nga komuniteti për projekt buxhetin afatmesëm 2023-2025, buxhetin e vitit 2023 si dhe paketen fiskale, bazuar në mundësitë ekonomike të Bashkisë pas problematikave të shkaktuara nga termeti, pandemia, kriza ekonomike e kohëve të fundit të cilët janë faktorë që ndikojnë dhe reflektojnë në buxhetin e bashkisë. Prioritet mbeten shërbimet dhe financimet për projektet e nisura. Dy shtyllat kryesore janë bujqësia dhe infrastruktura, janë mundësuar ndërhyrje në mbi 20 rrugë në total duke përfshirë rrugën e Kallmetit, Kodhelit, Dragushës etj. Një problem i rëndësishëm ka qenë borxhi prej 4,6 miliardësh i cili është gjetur në momentin e marrjes së pushtetit të qeverisjes vendore. Diskutimi u orientua drejt banorëve të pranishëm për sygjerime në lidhje me çfarë duhet përfshirë në buxhet, shërbime të cilat jo domosdoshmërisht duhet të përfshijnë edhe investime, problematika me rrugët apo ndërhyrje të ndryshme për të cilat kanë nevojë banorët e njësive administrative.

Problematika e parë e ngritur ishte rreth ujësjellësit të Rraboshtës. Zv.Kryetari në fjalën e tij shprehu se realizimi i këtij ujësjellësi është një vepër e madhe për t’u marrë përsipër nga Bashkia Lezhë, për shkak të koston së lartë, kryesisht të tilla projekte bëhen me financim të Qeverisë Shqiptare. Bashkia ka nderhyrë brenda mundësive dhe kapaciteteve por përfshirja në buxhet nuk është e mundur.

Kryeplaku i Torovicës ngriti si problem degradimin e rrugës së Torovicës. Lidhur me këtë problematikë Zv.Kryetari u shpreh se është bërë një plan ndërhyrje për këtë rrugë të amortizuar por në kushtet kur çmimet e materialeve janë rritur, kjo e vështirëson realizimin e këtij plan ndërhyrje. Kryesisht janë bërë ndërhyrje në rrugë duke marrë parasysh edhe numrin e popullsisë që ndikohet nga ajo rrugë, për shembull rruga në Kodër Balldre u shërben 150 familjeve ndërsa në Kolajakaj 20 familjeve, ndërkohë që kanë të njëjtën kosto për tu realizuar. Rruga nacionale nuk i kaluar në administrim Bashkisë Lezhë, nuk është marrë në dorëzim por që është brenda garancisë. Ndriçimi është mundësuar për rrugët si Dajç, Dragushë, Kallmet etj. Në tre vite janë vendosur 320 shtylla ndriçuese, kryesisht në qytet, qendrat e banuara. Buxheti i vitit 2023 do të shkojë për ndriçimin e njësive administrative, sipas popullsisë që ndikohet dhe përfiton prej saj. Duke qenë se kostoja për vendosjen e një shtylle aktualisht është rritur, dyfishuar kjo e bën këtë një proces më të vështirë por që do të realizohet.

Një banor tjetër ngriti si problematikë funksionimin e ujësjellësit të Mabës, problemin e furnizimit me ujë si dhe rrugën që lidh Mabën me Barbullushin një pjesë e të cilës ka ngel pa shtruar. Në përgjigje të kësaj Z.Ermal Pacaj u shpreh se është parashikuar një ndërhyrje për stabilizimin e kësaj rruge, afërsisht rreth 940 metra por që momentalisht nuk do të ndërhyhet me asfalt. Janë realizuar ndërhyrje përkatësisht 27 rrugë në paketën e parë dhe 21 rrugë në paketën e dytë, në total 48 rrugë brenda një mandati. Ndërhyrjet bëhen sipas numrit të personave që u shërben dhe momentalisht nuk bëhet për shkak të koston. Në këtë buxhet janë prioritet qendrat e banimit, aktualisht shpërndarja dhe sistemi është i tillë që e rrit koston për këto ndërhyrje, kosto e lartë në lek dhe kohë. Në këtë ujësjellës janë bërë 2 herë ndërhyrje.

Një banor i Njesisë Administrative Balldre ngriti si problematikë kushtet e urës lidhëse Rraboshtë-Balldre, anësorja e së cilës është e dëmtuar dhe rrezikon fëmijët, rruga në Balldre Kodër është e ngushtë dhe vështirëson kalimin e mjeteve të mëdha. Gjithashtu është e nevojshme ndriçimi i rrugës, problematike janë edhe pallatet e vjetra, gërmadhat si dhe kushtet jo normale të banjës. Në përgjigje të kësaj Zv.Kryetari u shpreh se problematika e pallatit dhe urës është diskutuar së fundmi me administratorin dhe do të bëhen ndërhyrje nga punëtorët e shërbimeve, të cilët do të shkojnë ta inspektojnë nga afër. Lirimi i hapësirave ngelet një problem për shkak të planit të ndërtimit, ku në fund të çdo rruge ndodhet një shtëpi, për pasojë çdo rrugë është e bllokuar dhe kjo e vështirëson procesin e punës.

Banorë të fshatit Gjadër ngriten si problem varrezat e kësaj zone, urën e Gjadrit, mungesa e telave si dhe mungesa e energjisë elektrike që është e njëjtë nga të gjithë. Këto problematika janë ngritur edhe në takime të tjera.

Zv.Kryetari u shpreh që për shkak të problematikës me pronësinë e tokave ka pasur vonesa por problemi është ndjekur, nuk është neglizhuar.

Kryeplaku i Fishtës e vendosi theksin në problematikën ndër vite për furnizimin me energji elektrike, amortizmin e rjetit. Në lidhje me këtë problematikë u sygjera që banorët duhet ti drejtohen OSHEE-së për shkak se nuk është kompetencë e bashkisë trajtimi i saj.

Në përfundim të shqetësimeve dhe sygjërimeve të banorëve Z.Ermal Pacaj bëri një përbledhje të buxhetit për vitin 2023, në të cilin parashikohet që pjesën më të madhe e zënë investimet e reja dhe ato në vazhdim. Mbi 500 km kanale kulluese janë hapur në territorin e Bashkisë Lezhë. Nëse Drejtoria e Bujqësisë ka bërë një kërkesë për x litra naftë ajo është kryer menjëherë përtej faktit të rritjes së çmimit. Në këtë mënyrë ka më shumë toka që punohen, më pak toka që përmythen. Një peshë të rëndësishme zënë edhe shpenzimet operative, ndërhyrjet në infrastrukturë. Gjithashtu 37% e buxhetit shkon për paga, sigurime të punonjësve, mesatarja e 3 viteve është afërsisht 36%, krahasuar me vitet më parë që ka qenë 46-52 %. Maksimumi i punonjësve përgjatë këtyre këtyre 3 viteve ka qenë 760 punonjës, nga 1000 e sa që kanë qenë më parë, kjo reflektohet në reduktim të shpenzimeve. Viti 2023 parashikohet të jetë viti me investimet më të mëdha.

Në përfundim të fjalës së tij, duke falenderuar pjesëmarrësit Zv.Kryetari theksoi se për çdo problematikë që mund të kenë banorët mund t'ua përcjellin kryeplakut të fshatit ose administratorit, pasi këtë javë dhe javën e ardhshme do të jemi të hapur për sygjërime.

**Drejtori i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diaspores,
Komunikimit dhe Transparencës**

Elson Firoku

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

Gjystina Nik-ulaj

